



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E FINANCAVE**  
*Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve*  
*Drejtoria e Mbikqyrjes Operacionale të Degeve Tatimore*

---

**AKTIVITETI I ADMINISTRATES TATIMORE LIDHUR ME MASAT PER  
ZGJERIMIN E BAZES SE TATIMPAGUESVE**

Per administraten tatimore shqiptare ka perbere shqetesim te vazhdueshem niveli i larte i informalitetit, i cili eshte konstatuar dhe deklaruar, si nga vete institucionet shqiptare, ashtu edhe nga ato te huaja qe asistojne vendin tone.

Ky problem, i cili eshte konsideruar si prioritet ne programin e Qeverise Shqiptare, ka perbere dhe perben sfiden kryesore te punes se strukturave tatimore.

Situata e trashëguar ne kete fushe ka qene mjaft problematike. Nga njera ane mijera subjekte qe zhvillojnë veprimtari ekonomike jashte evidencave dhe mbikqyrjes se organeve fiskale, pra totalisht informale, dhe nga ana tjeter subjekte qe deklarorin pjeserisht veprimtarine e tyre, duke fshehur ne kete menyre nje pjese te konsiderueshme te transaksioneve qe kryenin dhe rrjedhimisht edhe te qarkullimit dhe te fitimeve perkatese.

Nisur nga kjo situatë, kemi percaktuar prioritetet dhe kemi perpunuar programet perkatese ku dy drejtimet kryesore kane qene :

- formalizimi i operatoreve informale, pra regjistrimi dhe taksimi i tyre
- zbulimi i pjeses se fshehur dhe te padeklaruar te veprimtarise nga subjektet formale

Fillimisht, administrata tatimore ka ndermarre nje fushate intensive per sensibilizimin e publikut lidhur me kete fenomen. Jane organizuar dhjetra takime rajonale me perfaqesues te bizneseve dhe publikut. Ne televizionet kryesore kombatare, por edhe ato lokale jane organizuar emisione te vecanta per fenomenin e informalitetit. Jane prodhuar dhe shperndare nje sasi jo e vogel posterash dhe materialesh te tjera sensibilizues per te nxitur formalizimin e bizneseve dhe te punemarresve. Jane botuar ne faqet e internetit dhe te shtypin e shkruar te gjitha ato pjese te legjislacionit qe trajtojne procedurat e regjistrimit,

penalizimit per mosregjistrim dhe pune te zeze. Si rezultat i kesaj transparence dhe marredheniesh korrekte me publikun, eshte arritur qe ne jo pak raste te mos jete e nevojshme forca shtrenguese e strukturave te policise tatimore per formalizimin e biznesvev.

Formalizimi dhe regjistrimi i ekonomise informale ka filluar me rritme te shpejta pune nga tetori i vitit 2005. Vetem ne 3 mujorin e fundit te atij vitit u identifikuan dhe formalizuan rreth 6 mije biznese te rinj. Kjo pune ka vazhduar me rritme me te shpejta ne vitin 2006. Per kete periudhe 9 mujore jane identifikuar dhe formalizuar ne zyrat e administrates tatimore rreth 14 mije biznese te tjera. Tashme ne regjistrat e organeve tatimore rezultojne te regjistruar rreth 74 mije biznese, nga te cilat 60 mije jane biznese te vogla dhe te mesme te klasifikuara ne grupin e biznesit te vogel dhe 14 mije subjekte te klasifikuara si tatimpagues te TVSH-se..

Pra si rezultat i punes me te pergjegjshme te administrates se re tatimore, arrihet qe ne me pak se nje vit numuri i bizneseve te regjistruara te rritet me mbi 40 perqind. Kjo mase dhe keto arritje kane siguruar njekohesisht rritjen e kontributeve fiskale te gjeneruara nga keto biznese.

Por nisur nga fakti se ende ka probleme, ky proces do te vazhdoje ne menyre permanente me qellim mbylljen perfundimtare te ketij fenomeni te trasheguar ne vite dhe me pasoja ne konkurencen midis subjekteve.

Rritja e ndjeshme e numurit te tatimpaguesve te regjistruar dhe njekohesisht forcimi dhe permiresimi i kontrollit tatimor, ka dhene rezultate pozitive edhe ne kontributet e derdhura nga te punesuarit e ketij biznesi. Ne 9 mujorin e vitit ne vijim, ne llogariite e Institutit te Sigurimeve Shoqerore jane derdhur mbi 3,2 miliarde leke me teper se ne vitin 2005. Rezulton se numuri i kontribuesve qe paguajne keto kontribute eshte rritur me mbi 30.000 ne krahasim me fundin e vitit 2005.

Kjo arritje dhe keta tregues jane nje hap i pare i mire ne permiresimin rrenjesor te gjendjes jo normale qe ka ekzistuar per vite ne fushen e informalitetit te veprimtarive dhe punes masive ne te zeze te punemarresve.

Objektivat dhe strategjia jone synojne rritjen e te ardhurave nga kontributet e sigurimeve shoqerore ne raport me Produktin e Pergjithshem, qe automatikisht do te thote formalizim i ekonomise dhe reduktim i ndjeshem i punes ne te zeze, pra i punemarresve ilegale. Ne kete element shume te rendesishem, vendi yne ka parametrat me te ulet jo vetem ne raport me vendet e zhvilluara te kontinentit, por edhe me vendet e ne tranzicion te Ballkanit. Synimi yne eshte qe ne nje periudhe afatmesme, pjesa e kontributeve ne Produktin e Pergjithshem te rritet nga rreth 4 perqind qe eshte aktualisht, ne 8-9 perqind.

Per realizimin e objektivave ambicioze ne kete fushe, administrate tatimore ka ndermarre nje sere reformash ligjore, procedurale, organizative dhe strukturore :

- Ne kuadrin e reduktimit te barrierave administrative eshe thjeshtuar ne maksimum procedura e regjistrimit te tatimpaguesve. Sipas ndryshimit ligjor te miratuar ne gusht 2006, cdo tatimpagues qe kerkon te filloje veprimtari ekonomike, do te regjistrohet ne organet tatimore duke paraqitur vetem vendimin e gjykates. Kjo mase do te stimuloje dhe nxise shume tatimpagues sidomos te vegjel, te cilet mosregjistrimin ne organet fiskale e kane justifikuar me barrierat e shumta administrative.
- Ne ligjin e procedurave tatimore, ne kapitullin mbi detyrat e policise tatimore u shtua edhe nje detyre qe ka te beje me kontrollin e tregut informal te punes dhe vendosjen e gjobes nga kjo polici per cdo punonjes te evidentuar si i paregjistruar. Kjo mase do te sherbeje per nje kontroll permanent te tregut dhe te punemarresve
- Eshte punuar per hartimin e nje projekti lidhur me pagen referuese mujore per efekt te llogaritjes se kontributit te sigurimeve shoqerore dhe shendetsore per punemarresit e sektorit privat qe punojne ne pune te kualifikuara si dhe personelin drejtues tekniko ekonomik te tyre. Qellimi i kesaj mase eshte qe te perafroje pagen mbi te cilen paguhen kontributet me pagen reale qe marrin punonjesit e kualifikuar te sektorit privat, por qe nuk e deklarojne ne mase te plote.
- Eshte pergatitur projekti per reduktimin e nivelit te kontributeve te sigurimeve shoqerore dhe shendetsore per personat e vetpunesuar ne aktivitetet tregtare dhe te sherbimit ambulant, apo te quajturat minibiznese. Qellimi i ketij vendimi eshte qe te futen ne skemen e regjistrimit dhe pageses se kontributeve te sigurimeve shoqerore dhe shendetsore nje grup i madh personash qe aktualisht punojne ne te zeze. Realizimi i ketij projekti do te rrise ne menyre te dukshme si numurin e tatimpaguesve te regjistruar, ashtu edhe numurin e kontribuesve, duke realizuar ne kete menyre nje reduktim real dhe te thelle te ekonomise informale..

Per realizimin e misionit te saj te reduktimit te informalitetit dhe evazionit fiskal, administrata tatimore po bashkepunon dhe po bashkerendon punen me strukturaat e tjera shteterore te perfshira ne kete proces, dhe kryesisht me strukturat e Inspektoriatit Shteteror te Punes dhe Institutit te Sigurimeve Shoqerore.

- Perfaqesues te larte nga te tre institucionet e mesiperme kane kryer takime te vazhdueshme zonale ne shkalle prefekturash me drejtuesit perkates. Qellimi i ketyre takimeve eshte evidentimi i problemeve dhe caktimi i detyrave per permiresimin e bashkepunimit ne drejtim te masave

per minimizimin e informalitetit ne tregun e punes dhe shkembimit te informacionit.

- Nga strukturat e kontrollit te Drejtorise se Pergjithshme te Tatimeve, ne bashkepunim me Inspektoriatin Shteteror te Punes, jane realizuar kontrole ne sektorin e ndertimit me objektiv primar verifikimin e punes se zeze, regjistrimin e punonjesve dhe permbushjen e detyrimeve per kontributet e sigurimeve shoqerore dhe shendetsore nga subjektet e ndertimit.
- Eshte institucionalizuar shkembimi i informacionit me Institutin e Sigurimeve Shoqerore dhe Inspektoriatin Shteteror te Punes, lidhur me subjektet e regjistruara, punen e zeze te evidentuar nga kontrollet dhe futjen ne skemen e pagimit te kontributeve te tyre.
- Eshte rritur bashkepunimi me strukturat e pushtetit vendor per identifikimin e cdo biznesi dhe regjistrimin e tyre si ne organet fiskale vendore, ashtu edhe ne ato qendrore.
- Po identifikohen te gjitha hallkat licensuese te veprimtarive te ndryshme specifike si ne shendetsi, arsim, projektim, transport etj, duke kontrolluar njekohesisht regjistrimin e te gjithe operatoreve qe zoterojne keto licensa ne organet fiskale.

Puna e nisur nga administrata tatimore ne vitin 2006 do te thellohet ne vijim, cka do te rezultojte ne arritje konkrete dhe te matshme te uljes sinjifikative te informalitetit ne ekonomi dhe rritjen e te ardhurave fiskale qe gjenerohen nga keto biznese.

Ne kete kuader, administrata tatimore eshte ne ndjekje dhe realizim te vazhdueshem te detyrave te percaktuara nga Keshilli i MInistrave ne Vendimin perkates, me qellim arritjen e objektiveve ne sfiden e shtetit shqiptar me informalitetin.

**DREJTORIA E PERGJITHSHME E TATIMEVE**